



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 579/19 Prot.

Tiranë, më 16.02 2023

V E N D I M

Nr. 25 dt. 16.02 2023

“PËR
KORRIGJIMIN DIGJITAL TË PROVIMEVE ME SISTEMIN CLEANSORE”

Mbështetur në nenin 2, 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7 paragrafi 5, 19 dhe 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, në marrëveshjen e bashkëpunimit nr. 59 Prot. datë 14.01.202 lidhur ndërmjet Albanian- American Development Foundation (Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim) dhe Universitetit të Sporteve të Tiranës “Për zbatimin e projektit CleanScore, Cilësia e materialeve mësimore dhe vlerësimi i performancës së studentëve”, shkresës së Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit nr. 904/1 Prot. datë 07.06.2022 “Modulet që do të përdorin programin CleanScore në FVFR” dhe shkresës nr. 904 Prot. datë 06.06.2022 “Propozim për modulet pilot që do korrigjohen nëpërmjet programit CleanScore në FSHL”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 16.02.2023

V E N D O S I :

1. Miratimin e korrigjimit dixhital të provimeve me sistemin CleanScore që nga muaji mars 2023 e në vijim.
2. Ngarkohet Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit dhe Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit për zbatimin e këtij vendimi. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikimin e këtij Vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

